



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 67, paragrafi 6 të Ligjit nr. 05/L-045 për sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2016, miratoi:

## **RREGULLORE PËR VLERËSIMIN DHE MBAJTJEN E PROVIZIONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE PËR SIGURUESIT JETË DHE JOJETË**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore përcakton metodat e mbajtjes dhe vlerësimit të provizioneve teknike dhe matematike për siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm
2. Kjo Rregullore aplikohet për siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm që ushtrojnë aktivitete në Kosovë dhe që janë të licencuar, rregullohen dhe mbikëqyren nga BQK-ja.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për sigurimet ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimet e kësaj Rregulloreje.
  - a) "Provizione teknike" nënkupton shumën e përcaktuar në bazë të metodave aktuaristike, të cilat mbahen nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jojetës;
  - b) "Provizione matematike" nënkupton shumën e përcaktuar në bazë të metodave aktuaristike, të cilat mbahen nga siguruesi për të mbuluar përgjegjësitë, që rrjedhin nga kontratat e sigurimit të jetës;
  - c) "Subrogim" nënkupton të drejtën e siguruesit që të ndjekë një palë të tretë që ka shkaktuar dëmin e siguruar, për të cilin dëm siguruesi e ka kompensuar të siguarin,
2. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, përveçse kur është specifikuar ndryshe me dispozita të veçanta, me termin "Sigurues", nënkuptohen edhe degët e siguruesit të jashtëm,
3. Kudo që në këtë Rregullore është përdorur termi rezervë teknike nënkupton provizion teknik dhe anasjelltas.

### **Neni 3**

#### **Dispozitat e Përgjithshme**

1. Siguruesi duhet të krijojë dhe të mbajë provizione të mjaftueshme teknike dhe matematike, shuma e të cilave në çdo moment duhet përmbushë detyrimet të cilat rrjedhin nga kontratat e sigurimit.
2. Llogaritja e provizioneve teknike dhe matematike duhet të mbështetet me një opinion aktuarial nga aktuari i emëruar i siguruesit, i cili duhet të argumentojë se përdorimi i metodave të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe parimet aktuariale, si dhe të përshkruajë ndikimin e zbatimit të këtyre metodave në pozitën dhe performancën financiare të siguruesit.
3. Shuma e provizioneve teknike dhe matematike të vlerësuara dhe të mbajtura nga siguruesi nuk duhet të jetë më e ulët se shuma e cila rezulton nga kalkulimi i këtyre provizioneve në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në këtë Rregullore.
4. Siguruesi duhet që në çdo kohë të bëjë llogaritjen e provizioneve teknike dhe matematike në terma bruto, si dhe pjesën e provizioneve teknike të ceduar/transferuar tek risiguruesi që rrjedh nga kontrata e sigurimit.
5. Provizionet teknike dhe matematike në terma kontabël duhet regjistruar ndaras sipas llojit të provizioneve të parashikuara në nenin 4 paragrafët 1 dhe 2 kësaj Rregulloreje.
6. Provizionet teknike dhe matematike do të njihen dhe do të regjistrohen në regjistrat e kontabilitetit në valutën Euro. Ndërsa në rast të ndodhjes së transaksioneve në valutën e huaj, këmbimi do të bëhet në valutën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga BQK-ja, në ditën e llogaritjes së këtyre provizioneve.
7. Provizionet teknike dhe matematike do të llogariten në ditën e fundit të periudhave aktuale si në vijim:
  - a) për tremujorin e parë deri më 31 mars të vitit aktual,
  - b) për tremujorin e dytë deri më 30 qershor të vitit aktual,
  - c) për tremujorin e tretë deri më 30 shtator të vitit aktual,
  - d) për vitin e plotë kalendarik, më 31 dhjetor (llogaritja vjetore).

### **Neni 4**

#### **Llojet e provizioneve teknike dhe matematike sipas kontratave të sigurimit**

1. Siguruesit të cilët ushtrojnë aktivitet në sigurimet jojetë duhet të vlerësojnë dhe të mirëmbajnë në çdo kohë provizione teknike si në vijim:
  - a) Provizione për primin e pafituar (PPP) ose (ang: UPR)
  - b) Provizione për dëmet pezull, e cila përbëhet nga:
    - i. provizione për dëmet e raportuara por jo të rregulluara (ang: RBNS reserve);
    - ii. provizione për dëmet e ndodhura por jo të raportuara (ang: IBNR reserve);

- iii. provizione për shpenzimet e trajtimit të dëmeve.
  - c) Provizione për riskun e paskaduar.
  - d) Provizione të barazimit të dëmeve (në rast se aplikohet).
2. Siguruesit të cilët ushtrojnë aktivitet në sigurimin e jetës, duhet të vlerësojnë dhe të mirëmbajnë provizione teknike dhe matematike si në vijim:
- a) Provizione Matematike;
  - b) Provizione për primin e pafituar;
  - c) Provizione për benefite shtesë;
  - d) Provizione sipas paragrafit 1 të këtij neni, në rast se aplikohet.

## Neni 5

### Përcaktimi i Provizionit për Primin e Pafituar

1. Provizionit për primin e pafituar përbëhet nga pjesa e primeve të shkruara bruto në raport me periudhën e paskaduar të kontratës së sigurimit. Ky provizion duhet të mbahet nga fillimi i periudhës së kalkulimit të provizioneve teknike e deri në skadimin e kontratës së sigurimit, në mënyrë që të mbulohen shpenzimet dhe dëmet të cilat rrjedhin brenda periudhës efektive të kontratës së sigurimit.
2. Provizionit për primin e pafituar llogaritet ndaras për çdo kontratë të sigurimit.
3. Provizionit për primin e pafituar (RPP) për një kontratë të sigurimit do të kalkulohet sipas metodës “pro rata temporis”, duke përdorur formulën si në vijim:

$$PPP_i = PSHB_i * \frac{DM_i}{TD_i}, \text{ ku:}$$

$PPP_i$  = Provizionit për primin e pafituar;

$PSHB_i$  = Primi i shkruar bruto pa TVSH;

$DM_i$  = Numri i ditëve të mbetura deri në skadimin e kontratës së sigurimit për të cilin është paguar primi i sigurimit ( $PSHB_i$ ) dhe i cili do të përcaktohet si diferencë ndërmjet numrit të përgjithshëm të ditëve valide të kontratës ( $TD_i$ ) dhe numrit të ditëve të skaduara nga lëshimi i kontratës në fuqi.

$TD_i$  = Numri i përgjithshëm i ditëve të vlefshme të kontratës së sigurimit për të cilin është paguar primi i shkruar bruto ( $PSHB_i$ ) në mbulim të kontratës.

$i$  = kontrata e sigurimit për të cilin është kalkuluar provizionit për primin e pafituar.

4. Gjithsej provizionit për primin e pafituar është i barabartë me shumën e të gjitha provizioneve të primeve të pa fituara nga secila kontratë e sigurimit ( $PPP_i$ ) për të cilën është shkruar primi nga data e vlerësimit dhe shprehet me këtë formulë:

$$PPP_t = \sum_{i=1}^n RPP_i, \text{ ku:}$$

$PPP_t$  = Gjithsej provizioni për primin e pafituar në datën  $t$

$n$  – numri i kontratave për të cilat është kalkuluar provizioni për primin e pafituar (PPP).

5. Për kontratat e sigurimit të cilat hyjnë në fuqi në një datë më vonë se kur primet e shkruara për këto kontrata të jenë regjistruar në librat kontabël, provizioni për primin e pafituar do të jetë e barabartë me primin e shkruar.
6. Shuma (pjesa) e risiguruesit në provizionet teknike për primin e pafituar do të llogaritet ndaras për çdo kontratë të sigurimit sipas marrëveshjes së bërë për risigurimin proporcional në përputhje me dispozitat e kontratës së sigurimit. Risigurimi joproporcional nuk do t'i zvogëlojë provizionet për primin e pafituar.
7. Provizioni për primin e pafituar nuk duhet të jetë në shumë negative për asnjë kontratë efektive të sigurimit.

## Neni 6

### Përcaktimi i provizioneve për dëmet pezull

1. Provizionet për dëme pezull bruto paraqesin shumën e dëmeve të raportuara dhe jo të raportuara deri në datën e vlerësimit sipas përshkrimit në nenin 4 paragrafi 1, nënparagrafi b) të kësaj Rregulloreje.
2. Provizionet për dëmet pezull bruto përfshijnë shumën të gjitha dëmeve të raportuara dhe jo të raportuara të siguruesit për të cilat akoma nuk është bërë pagesa e plotë deri në datën e vlerësimit të tyre. Siguruesi është i detyruar të mirëmbajë provizionet për dëmet pezull në mënyrë që të shërbejë për pagesën e dëmeve në të ardhmen si dhe të mbulojë shpenzimet e trajtimit të dëmeve për rastet e siguruar si në vijim:
  - a) kur kërkesa/aplikacioni për dëm është pranuar, por për të cilën akoma nuk është bërë pagesa në tërësi nga siguruesi deri me datën e vlerësimit (më tej – RBNS),
  - b) kur dëmi ka ndodhur, por kërkesa/aplikacioni për dëm lidhur më këtë ngjarje nuk është raportuar te siguruesi (më tej – IBNR).
3. **Provizioni për dëmet e raportuara por jo të rregulluara (RBNS)** do të llogaritet ndaras për çdo kontratë të sigurimit në përputhje me aplikacionin e dëmit të siguruar, nëse:
  - a) siguruesi ka marrë/pranuar aplikacionin lidhur më një ngjarje të siguruar si dhe ka bërë vlerësimin për dëmin e siguruar. Në këtë rast, RBNS duhet të vendoset në shumën e vlerësuar të dëmit. Vlerësimi i dëmit të siguruar duhet të jetë i arsyeshëm dhe i dokumentuar.
  - b) dëmi i siguruar paguhet në formën e pagesave periodike (p.sh. aftësia e kufizuar, pensioni i mbijetesës etj.). Nëse kohëzgjatja e pagesave periodike është e njohur, provizioni RBNS do të llogaritet duke kapitalizuar vlerën aktuale të të gjitha shpenzimeve të pritshme në të ardhmen.

- c) kërkesa për dëm është objekt i procedurave ligjore në gjykatë. Në këtë rast RBNS do të vendoset në shumën e dëmeve mesatare të paguara nga siguruesi për llojin e njëjtë të kontratave të sigurimeve ose për ngjarje të natyrës së njëjtë, që i përket kërkesave për dëm që është objekt i procedurave gjyqësore. Kjo shumë do të mbahet si provizion RBNS deri në vendimin përfundimtar të formës së prerë nga gjykata. Po ashtu, siguruesi duhet të mbajë si provizion çdo shpenzim shtesë, shuma e të cilit është e njohur në lidhje me trajtimin e dëmit.
  - d) kërkesa për dëm është raportuar te siguruesi, por madhësia apo shuma e dëmit akoma nuk është e njohur për siguruesin, atëherë RBNS do të jetë e barabartë me mesataren e shumës së dëmeve të paguara nga siguruesit për llojin e njëjtë të kontratave të sigurimeve ose për ngjarjet e natyrës së njëjtë.
4. Shuma (pjesa) e risiguruesit për provizionin RBNS do të kalkulohet ndaras për çdo kontratë të sigurimit në përputhje me dispozitat e kontratës së risigurimit.
5. Provizionin për RBNS për lloje të veçanta të sigurimit mund të zvogëlohet nga shuma e cila rikuperohet përmes cedimit. Për këto shuma siguruesi duhet të posedojë informata për secilën grup të kontratave të sigurimit në mënyrë që të mund të vlerësojë me kujdes shumën e tyre. Në qoftë se siguruesi nuk ka të dhëna të tilla statistikore, RBNS nuk do të zvogëlohet për këto shuma.
6. Provizionin për RBNS nuk duhet të jetë në shumë negative për asnjë kontratë efektive të sigurimit.
7. Siguruesi është i obliguar të mirëmbajë regjistrin e dëmeve sipas kërkesave të parashikuara në **Aneksin I**, në mënyrë që të gjitha dhënat dhe dokumentet lidhur me dëmet e ndodhura dhe të raportuara, përfshirë këtu datat e dëmeve të zgjidhura (paguara) të kryhen në baza ditore.
8. **Provizionet për dëmet e ndodhura por jo të raportuara (IBNR)** duhet të llogaritet për çdo klasë të biznesit të sigurimeve, në bazë të praktikave më të mira nga siguruesi, nga metodat aktuariale, duke përdorur të dhëna të arsyeshme statistikore. Ky provizion duhet të vendoset dhe të mbahet për dëme të cilat kanë ndodhur, por të cilat nuk janë raportuar deri në datën e vlerësimit të provizionit.
9. Në rast se në përcaktimin e provizionit (IBNR) përdoret “*metoda e trekëndëshit*” të zhvillimit të dëmeve (p.sh metoda shkallë-zinxhir etj., kjo metodë duhet të bazohet në metodologjinë dhe supozimet aktuariale të cilat së paku plotësojnë kërkesat si në vijim:
  - a) Trekëndëshat e zhvillimit të dëmeve duhet të prezantohen duke përdorur të dhëna tremujore ose vjetore, së paku për 20 tremujorët ose 5 vitet e periudhave paraprake kontabël lidhur me dëmet e paguara dhe dëmet e raportuara por jo të rregulluara (të ndodhura) në kalkulimin e këtij provizioni.
  - b) Të dhënat statistikore të cilat përdoren në kalkulimin e provizioneve për dëmet e ndodhura por jo të raportuara nuk duhet të marrin parasysh shumën e “subrogimeve”, pjesëve të shpëtuarra (ang: salvages) dhe regreseve.
  - c) Dëmet e pazakonta të vlerave shumë të larta, mund të përjashtohen nga të dhënat statistikore në kalkulimin e IBNR, në qoftë se aktuari e konsideron së kjo kërkohet me praktikën më të mira të vlerësimit të provizioneve. Në këtë rast, aktuari do të japë një shënim të veçantë lidhur me arsyet e përjashtimit të këtyre vlerave nga kalkulimi.

- d) Në qoftë se siguruesi ofron shërbime të çdo lloji të sigurimit për një periudhë më pak se tri vite, dhe të dhënat statistikore të përdorura nga ky sigurues nuk mjaftojnë për kalkulimin e provizionit IBNR me “metodën trekëndëshave”, atëherë provizioni për IBNR i kalkuluar me ndonjë metodë tjetër nuk duhet të jetë më pak se 10% (dhjetë për qind) e primeve të shkruara bruto brenda periudhës 12 mujore për llojin përkatës të sigurimit.
- e) Në qoftë se përdorimi i metodës së trekëndëshave nuk jep rezultate të arsyeshme, atëherë llogaritja e IBNR do të bëhet në bazë të gjykimit profesional të aktuarit të siguruesit me një shënim sqarues në opinionin aktuarial.
10. Shpenzimet e menaxhimit të dëmeve si dhe shpenzimet e tjera të trajtimit të dëmeve duhet të llogariten ndaras për çdo klasë biznesi. Këto shpenzimet do të llogariten duke aplikuar një përqindje të caktuar në provizionet për dëme (IBNR dhe RBNS).
11. Po ashtu, në bazë të kërkesave të cilat rrjedhin nga Rregullorja për “Fondin e Kompensimit të BKS”, po ashtu edhe për sigurimet kufitare, siguruesit janë të obliguar të mbajnë provizione për dëmet e ndodhura dhe të raportuara (RBNS), për dëmet jo të raportuara (IBNR) si dhe shpenzime tjera të trajtimit të dëmeve.

## Neni 7

### Provizioni për riskun e pa skaduar

1. Provizioni për riskun e paskaduar (më tej PRP) do të kalkulohet duke i vlerësuar dëmet dhe shpenzimet të cilat priten të ndodhin pas përmbylljes së vitit financiar dhe të cilat janë të lidhura me kontratat e sigurimit në fuqi deri në datën e vlerësimit. Siguruesi është i obliguar të mbajë provizion shtesë për riskun e pa skaduar, nëse provizioni për primin e pafituar (PPP) nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar dëmet dhe shpenzimet e pritshme të cilat lidhen me kontratat e sigurimit në fuqi.
2. Baza e llogaritjes së (RRP) është vlera e (RPP) në datën e llogaritjes.
3. Siguruesi është i obliguar të kryej testin e mjaftueshmërisë për çdo periudhë kontabël, duke mbuluar 12 muajt e fundit lidhur me provizionin për riskun e pa skaduar.
4. Provizionet teknike për riskun e pa skaduar (PRP) për lloje të sigurimit do të kalkulohet me formulën si në vijim:

$$PRP = \left( \frac{DNN + SHON}{PSHN - \Delta NPP} - 1.00 \right) \times PPP ,$$

siguruesit do të mbajnë provizion shtesë (PSH) për riskun e paskaduar vetëm në rast se plotësohet kushti:  $RSH \geq \max(0, PRP)$

ku:

DMN – Dëmet e ndodhura neto.

SHON – Shpenzimet operative neto<sup>1</sup>.

PSHN – Primi i shkruar neto.

$\Delta NPP$  - Ndryshimi në primin e pafituar neto.

PPP – Provizioni për primin e pafituar.

5. Provizioni për riskun e pa skaduar duhet të mbahet ndaras për çdo klasë të biznesit të sigurimit.

## **Neni 8**

### **Provizioni teknik për barazimin e dëmeve**

1. Ky provizion teknik ka për qëllim të zbusë luhatjet e mëdha nga viti në vit në zhvillimin e dëmeve.
2. Për dëmet të cilat rezultojnë me ashpërsi të lartë dhe frekuencë të ultë (p.sh. dëmet nga katastrofat) siguruesit mund të formojnë provizione teknike për të përmbushur vazhdimisht dhe në mënyrë të qëndrueshme detyrimet të cilat rezultojnë nga këto rreziqe dhe të cilat nuk janë transferuar të risiguruesit.
3. Në rastin e bashkësigurimit, siguruesit që marrin pjesë në bashkë-sigurim, duhet t'i ndërtojnë provizione teknike të sigurimeve në një masë të tillë, që t'iu korrespondojnë detyrimeve të secilës palë.

## **Neni 9**

### **Përcaktimi i provizioneve matematike**

1. Kompanitë e angazhuara në sigurimin e jetës janë të obliguara të mbajnë shuma adekuate të provizioneve matematike në përputhje me parimet aktuariale, në mënyrë që të mbulojnë detyrimet e tyre ndaj të siguruarve (përfituesve nga sigurimin i jetës, sigurimi i aksidenteve personale dhe mjekësore) në periudha kohore më shumë se një vit.
2. Provizionet matematike në sigurimin e jetës do të kalkulohen në baza aktuariale duke përdorur metodën e ardhshme të llogaritjes (metoda prospektive), ku provizioni është i barabartë me diferencën ndërmjet vlerës aktuale të detyrimeve të pritshme në të ardhmen të siguruesit dhe vlerës aktuale të primeve të ardhshme të pagueshme në bazë të kontratave të sigurimit.
3. Provizionet matematike në sigurimin e jetës do të llogariten sipas dispozitave të kontratës së sigurimit duke përfshirë:
  - a) shumën e pagueshme të sigurimit në rast të ndodhjes së një ngjarje apo disa ngjarjeve të siguruara,
  - b) bonuset e deklaruar për të cilat policëmbajtësit qoftë kolektivisht apo individualisht janë titullar,
  - c) shumën e pagueshme në rastin kur kontrata anulohet para skadimit të saj,

---

<sup>1</sup> Shpenzimet neto operative nënkuptojnë të gjitha shpenzimet të cilat lidhen me aktivitetin e siguruesit të zvogëluara për komisionet e risigurimit dhe DAC.

- d) ndryshimin e kushteve të kontratës ose modifikimit të kontratës,
  - e) shpenzimet lidhur me kontratën e sigurimit përfshirë këtu dhe komisionet,
  - f) primet e sigurimit të arkëtueshme në të ardhmen.
4. Provizionet matematike në sigurimin e jetës do të kalkuloohen ndaras për çdo kontratë të sigurimi Jetë, duke përdorur metodat aktuariale-matematikore dhe tabela të mortalitetit që korrespondojnë me llojin e kontratës. Provizionet matematike të sigurimit të jetës për kontratat e sigurimit në grup, me përbërje të ndryshme të personave të siguruar, do të llogariten ndaras për çdo person të siguruar.
  5. Norma e interesit e cila përdoret për kalkulimin e vlerës aktuale me metodën “prospektive” do të përcaktohet duke respektuar parimin e arsyeshmërisë dhe valutën në të cilën siguroesi ka ndërmarrë detyrimet. Norma e interesit e cila përdoret në kalkulimin e vlerës aktuale nuk duhet të jetë më shumë se 3.5%.
  6. Provizionet matematike të kontratës së sigurimit të jetës nuk do të jenë më të vogla se shuma e siguruar në rast të anulimit të kontratës (ang: surrender value) në momentin e caktuar, nëse kontrata e sigurimit parashikon pagesën të caktuar në rastin e anulimit të kontratës ose në rast të ndodhjes së një ngjarje.
  7. Metoda “retrospektive” për llogaritjen e provizioneve matematike të sigurimeve jetë do të zbatohet në rastet kur aplikimi i metodës së ardhshme “prospektive” nuk është e mundur. Norma e interesit e përdorur për llogaritjen e provizioneve teknike me metodën retrospektive nuk do të jetë më e ulët se norma e interesit e dhënë në kontratën e sigurimit.
  8. Nëse gjatë kalkulimeve, shuma e provizioneve matematike të sigurimit të jetës rezulton negative, kjo shumë do të konsiderohet e barabartë me zero.
  9. Shuma e risigurimit në provizionet teknike dhe matematike të sigurimit të jetës do të llogaritet ndaras për çdo kontratë sigurimi në përputhje me dispozitat e kontratës së risigurimit.
  10. Provizionet teknike dhe matematike të sigurimeve të jetës të lidhura për njësi investimi (ang: unit-linked) do të mbahen në përputhje me vlerën e aseteve të cilat sipas dispozitave të kontratës së sigurimit, përcaktojnë shumën e kontratës së sigurimit, shumën e kërkesave për dëm, si dhe shumën në rast të anulimit të kontratës para maturimit të saj (ang: surrender value).
  11. Në qoftë se siguroesi, në përputhje me dispozitat e kontratës së sigurimit të jetës të lidhura për njësi investimi (ang: Unit-Linked), me rastin e ndodhjes së një ngjarje të caktuar garanton një shumë të caktuar të pagesës, e cila shumë nuk është e lidhur me shumën e aseteve të specifikuar në kontratë, atëherë siguroesi po ashtu është i obliguar të mbajë provizion teknik dhe matematik të sigurimit të jetës për kontratat e lidhur për njësi investimi duke respektuar dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.



## **Neni 10**

### **Pjesëmarrja e risiguruesit në provizionet teknike dhe matematike bruto**

1. Pjesa e risiguruesit në provizionet teknike dhe matematike bruto do të përcaktohet sipas paragrafëve 5, 6 dhe 7, të këtij neni, varësisht nga lloji, kushtet dhe afatet kohore të kontratës së risigurimit.
2. Siguruesi do të kalkulojë dhe të mbajë pjesën e risiguruesit në provizionet teknike dhe matematike si aset në pasqyrat e saj financiare në të njëjtën kohë me llogaritjen e shumës së provizioneve teknike dhe matematike bruto. Pjesa e risiguruesit do të llogaritet dhe të raportohet ndaras për secilin lloj të provizioneve teknike dhe matematike dhe duhet të jetë i dokumentuar mirë, me dokumente të nevojshme të cilat vërtetojnë se risku është transferuar (ceduar) te risiguruesi.
3. Në përcaktimin e pjesës së risiguruesit në provizionet teknike dhe matematike, që rezulton nga kontratat e ceduara/transferuara tek risiguruesi, duhet të merret parasysh aftësia e siguruesit për të paguar kompensimit e dëmit të risiguruar si dhe përshtatshmëria e rikuperimit të kësaj pagesë nga risiguruesi.
4. Transferimi i aseteve ndërmjet siguruesit (ceduesit) i cili transferon riskun dhe risiguruesit i cili pranon riskun duhet të jetë transparent, i vërtetë dhe i plotë.
5. Pjesa e risiguruesit në provizionin për primin e pafituar bruto që rezulton nga kontratat e ceduara tek risiguruesi, do të llogaritet në përputhje me metodën e përdorur për llogaritjen e (RPP) të përshkruar në këtë Rregullore, ose në rast se kjo metodë nuk zbatohet, atëherë në përputhje me klauzolat e kontratës së risigurimit, në datën kur kontrata hyn në fuqi.
6. Pjesa e risiguruesit në provizionet për dëmet e raportuara por jo të rregulluara (RBNS) që rezulton nga kontratat e ceduara tek risiguruesi, do të kalkulohet ndaras për çdo kontratë të sigurimit, në përputhje me kushtet e kontratës dhe shumën e rikuperueshme nga risiguruesi për dëmin e raportuar.
7. Pjesa e risigurimit në provizionet matematike do të kalkulohet ndaras për çdo kontratë të sigurimit ose grup të kontratave sipas dispozitave të kontratës së risigurimit ose programit të risigurimit.

## **Neni 11**

### **Mbajtja dhe raportimi i provizioneve teknike dhe matematike**

1. Provizionet teknike dhe matematike krijohen para se të nxirret rezultati i aktivitetit financiar në përputhje me Ligjin e sigurimeve dhe Rregulloren për raportim financiar.
2. Provizionet teknike dhe matematike duhet të paraqiten sipas llojit të tyre dhe të raportohen në pasqyrat financiare të siguruesit 30 ditë pas përfundimit të tremujorit, si dhe në baza vjetore pas përfundimit të vitit financiar.

3. Për provizionet teknike dhe matematike të siguruesit të paraqitura në bilancin e fund vitit dhe të secilit tremujor, duhet të bëhet mbulimi me asete të investuara në drejtime të ndryshme në përputhje me “Rregullore për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve”.

## **Neni 12**

### **Plani financiar**

1. Në rastet kur BQK-ja vlerëson se provizionet teknike dhe matematike nuk janë të mjaftueshme ose nëse mbulimi që është parashikuar për to nuk është i kënaqshëm, BQK-ja mund të kërkojë nga siguruesi që të paraqesë për miratim pranë BQK një plan financiar.
2. Plani financiar duhet të jetë për periudhe kohore, jo më tepër se gjashtë mujore dhe duhet të përmbajë masa për rivendosjen e provizioneve teknike dhe matematike të siguruesit dhe mbulimin e tyre. Siguruesi duhet të paraqesë planin financiar për miratim në BQK, brenda 30 ditëve nga pranimi i kërkesës.
3. BQK do të vendosë brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për miratim të planit financiar, nëse plani financiar është i përshtatshëm për rivendosjen e provizioneve teknike dhe matematike të siguruesit. Në rast se plani financiar nuk miratohet ose zbatimi i tij dështon, BQK-ja ka të drejtë:
  - a) Të kufizojë ose të ndalojë përkohësisht siguruesin në përdorimin e aseteve gjatë aktivitetit të tij, deri në plotësimin e kërkesave të BQK-së.
  - b) Të imponojë siguruesit transferim zyrtar të portofolit të sigurimeve.
  - c) Të kërkojë përgatitjen e një plani tjetër financiar nga ana e siguruesit dhe të paraqesë për miratim në BQK.

## **Neni 13**

### **Shtojcat**

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje janë edhe: Shtojca I dhe II.

## **Neni 14**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 2 maj 2016. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje të gjitha rregullat, rregulloret dhe udhëzimet që rregullojnë çështjen e provizioneve teknike dhe matematike të siguruesve shfuqizohen.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

## Shtojca I

### Baza e të dhënave që duhet të raportohet në BQK dhe e cila shërben si bazë për llogaritjen e provizioneve teknike.

Krahas llogaritjes dhe mbajtjes së provizioneve teknike, kompanitë e sigurimeve duhet të raportojnë edhe bazën e të dhënave që është marrë për bazë në llogaritjen e provizioneve teknike të sipër cekura. Më poshtë paraqesim të dhënat e kërkuara sipas tabelave:

**Tabela 1.** Të dhëna mbi primet e shkruara dhe rreziqet e siguruara nga siguruesi

Numri serik i policës së sigurimit
Emri dhe mbiemri i policëmbajtësit
Lloji i kontratës së sigurimit
Data e lidhjes së kontratës së sigurimit
Data e skadimit të kontratës së sigurimit
Të dhënat mbi objektin e siguruar
Vlera Bruto e Primit të shkruar
Pjesa e Primit të transferuar tek risiguruesi
Shuma e siguar
Shuma e siguar e transferuar tek risiguruesi
Shpenzimet fillestare dhe komisionet e marrjes në sigurim

**Tabela 2.** Të dhënat mbi dëmet e ndodhura

Numri serik i praktikës së dëmit
Numri serik i policës së sigurimit
Të dhënat lidhur me dëmin
Data e fillimit të kontratës së sigurimit
Data e mbarimit të kontratës së sigurimit
Data e ndodhjes së dëmit
Data e raportimit të dëmit
Lloji i dëmit (material, jomaterial)
Vlera e dëmit të vlerësuar nga kompania
Vlera e dëmit e paguar nga siguruesi (sipas llojit të dëmit)
Data e pagesës së dëmit për çdo pagesë të bërë
Statusi i praktikës së dëmit (p.sh. Pezull, i paguar, i mbyllur etj.)
Provizionet teknike për dëme pezull (sipas llojit të dëmit)
Të dhënat për pjesën e risiguruesit në dëm (duke përfshirë pagesat dhe pjesën e risiguruesit në provizionet për dëme)

Të dhënat e lartë cekura duhet të plotësohen për të gjitha periudhat e mëparshme, duke marrë në konsideratë të gjitha dëmet qofshin ato në proces gjyqësor, të paguara, pezull apo të refuzuara nga kompanitë e sigurimeve.

Këto të dhëna raportohen në BQK së bashku me llogaritjet e provizioneve teknike, brenda 30 ditëve kalendarike nga fundi i çdo tremujori.

**Shtojca II**  
**Forma e raportimit të provizioneve teknike**

**Tabela A1.** Struktura e provizioneve për primin e pafituar për periudhën: \_\_\_\_\_

Klasa	Emërtimi i klasës së biznesit	Prime të shkruara	Rezerva për primin e pafituar dhe rrezikun e paskaduar	Pjesa e risiguresit	Rezerva për primin e pafituar neto nga risiguresi
1	2	3	4	5	6
1	Sigurime nga aksidentet				-
2	Sigurime shëndeti				-
3	Sigurime të mjeteve tokësore				-
4	Sigurime të mjeteve lëvizëse mbi shina				-
5	Sigurime avionësh				-
6	Sigurime të anijeve				-
7	Sigurime të mallrave në transport				-
8	Sigurime nga zjarri dhe forcat tjera natyrore				-
9	Sigurime nga dëmtimet në pronë				-
<b>10</b>	<b>Përgjegjësi motorike</b>	-	-	-	-
	TPL				-
	TPL+				-
	Kufitare				-
	Fondi Kompensimit				-
11	Sigurime të përgjegjësisë nga përdorimi i avionëve				-
12	Sigurime të përgjegjësisë nga përdorimi i anijeve				-
13	Sigurime të përgjegjësisë të përgjithshme				-
14	Sigurime të kredisë				-
15	Sigurime garancionesh (suretyship)				-
16	Sigurime nga humbje të ndryshme financiare				-
17	Sigurime të shpenzimeve ligjore				-
18	Sigurime për asistencë				-
	<b>Total</b>	-	-	-	-

Aktuari i autorizuar i kompanisë

\_\_\_\_\_  
(Emri dhe Mbiemri, vula e kompanisë)

\_\_\_\_\_  
vendi dhe data

**Tabela A2. Struktura e provizioneve për dëmet për periudhën:** \_\_\_\_\_

Klasa	Emërtimi i klasës së biznesit	Rezerva për dëmet e raportuara por jo të regulluara (RBNS)	Rezerva për dëmet e ndodhura por të paraportuara (IBNR)	Rezerva për shpenzimet e trajtimit të dëmeve	Pjesa e risigurimit	Rezerva për dëmet neto nga risig. (3+4+5-6)
1	2	3	4	5	6	7
1	Sigurime nga aksidentet					-
2	Sigurime shëndeti					-
3	Sigurime të mjeteve tokësore					-
4	Sigurime të mjeteve lëvizëse mbi shina					-
5	Sigurime avionësh					-
6	Sigurime të anijeve					-
7	Sigurime të mallrave në transport					-
8	Sigurime nga zjarri dhe forcat tjera natyrore					-
9	Sigurime nga dëmtimet në pronë					-
10	<b>Përgjegjësi motorike</b>	-	-			-
	TPL					-
	TPL+					-
	Kufitare					-
	Fondi i Kompensimit					-
11	Sigurime të përgjegjësisë nga përdorimi i avionëve					-
12	Sigurime të përgjegjësisë nga përdorimi i anijeve					-
13	Sigurime të përgjegjësisë të përgjithshme					-
14	Sigurime të kredisë					-
15	Sigurime garancionesh (suretyship)					-
16	Sigurime nga humbje të ndryshme financiare					-
17	Sigurime të shpenzimeve ligjore					-
18	Sigurime për asistencë					-
	<b>Total</b>	-	-	-	-	-

Aktuari i autorizuar i kompanisë

\_\_\_\_\_  
(Emri dhe mbiemri, vula e kompanisë)

\_\_\_\_\_  
vendi dhe data



Viti i Aksidentit	Dëmet e paguara, vlera bruto											
	Vitet e zhvillimit											
	-	1	2	3	4	5	6	7	8	>	Total	
<												-
N-8												-
N-7												-
N-6												-
N-5												-
N-4												-
N-3												-
N-2												-
N-1												-
Viti aktual N												-

**Tabela B2. Zhvillimi i dëmeve në numër.**

Viti i Aksidentit	Dëmet e ndodhura (të paguara dhe të papaguara), dëme në numër											
	Vitet e Zhvillimit											
	-	1	2	3	4	5	6	7	8	>	Total	
<												-
N-8												-
N-7												-
N-6												-
N-5												-
N-4												-
N-3												-
N-2												-
N-1												-
Viti aktual N												-

Viti i Aksidentit	Dëme të paguara, numri i dëmeve											
	Vitet e Zhvillimit											
	-	1	2	3	4	5	6	7	8	>	Total	
<												-
N-8												-
N-7												-
N-6												-
N-5												-
N-4												-
N-3												-
N-2												-
N-1												-
Viti aktual N												-

Trekëndëshat konstruktohen të veçantë për klasë të ndryshme të sigurimit. Këto janë të obligueshme për klasën TPL të sigurimit dhe klasat e policave që të hyrat nga primi i tyre kalojnë 10% të hyrave totale të primit vjetor.